



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (c dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-179 për transportin rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 21 / 13 qershor 2013), nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – PLANIT TË TRASPORTIT RRUGOR LOKAL PËR KOMUNËN E DEÇANIT 2023-2028

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Konsultim Publik të Draft- Planit të Transportit Rrugor Lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028

II.

Vënia në Konsultim Publik e Draft- Planit të Transportit Rrugor Lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët, në mënyrë që i njëjti të jetë sa më funksional për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-4
Deçan,dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38171
01 08.11.23



Na osnovu člana 12 stav 12.1 i 12.2 slova (c i d) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 "Službeni list Republike Kosovo" br.28 od 04.06.2008. , Statuta Opštine Dečani, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, na osnovu člana 6 stav 2 Zakona br. 04/L-179 za drumski transport (Službeni list Republike Kosovo / br. 21 / 13. jun 2013), član 6 tačka 1.6 Administrativnog uputstva (MAPL) br. 06/2018 o minimalnim standardima javnih konsultacija u opštinama , Skupština opštine Dečane na sednici održanoj 31.10.2023 godine, prima sledeće:

ODLUKA

ZA JAVNE KONSULTACIJE NACRT - LOKALNI PLANA DRUMSKOG SAOBRAĆAJA ZA OPŠTINU DEČAN 2023-2028.

I.

Usvaja se Odluka o javnoj raspravi o nacrtu plana lokalnog drumskog saobraćaja za opštinu Dečani 2023-2028.

II.

Javne konsultacije o Nacrtu plana lokalnog drumskog saobraćaja za opštinu Dečane 2023-2028 su urađene sa ciljem da se obezbede doprinosi institucija, stručnjaka iz relevantne oblasti i građana, kako bi bio što funkcionalniji za subjekte za sprovođenje. i drugi.

III.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine, kao i objavljivanja na sajtu Opštine.


IV.

Odluka se donosi transparentno objavljivanjem na zvaničnom sajtu opštine, oglasnoj tabeli i kancelariji za informisanje opštine Dečani.

01.Br.IX-4

Dečane,dt.31.10.2023

Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ





Në bazë të kërkesës së Komisionit të Aksionerve të NPL "Higjiena" sh.a. të dt.16.10.2023, nr.01-355534, për kompensimin e Komisionit të Aksionerve të NPL "Higjiena" sh.a., në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në mbështetje të Nenit 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31/2008) i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin. Nr.04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.13/2012) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-009), nenit 26 pika 7. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË KOMISIONIT TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "HIGJIENA" SH.A.

I.

Miratohet Vendimi për përcaktimin e kompensimit të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Higjiena" sh.a.

II.

Çdo anëtar i Komisionit të Aksionarëve do të kompenzohet për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" sh.a. duke filluar nga data e emërimit të tyre.

III.

Mjetet për kompensimin e komisionit të aksionarëve do të merren nga buxheti i Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" sh.a.

IV.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" sh.a.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.IX-6

Deçan,dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçani AS 38/69

01

08.11.23



Na osnovu zahteva Odbora akcionara NPL "Higijena" sh.a. od 16.10.2023, broj 01-355534, za naknadu Komiteta akcionara NPL "Higijena" sh.a., na osnovu odredbi člana 12 stav 12.2 tačka (d) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 /L-040 ("Službeni list Republike Kosovo", br. 28/2008), u prilog članu 5.2 Zakona br. 03/L-087, o javnim preduzećima (Službeni list R. Kosova broj 31/ 2008) dopunjen i izmenjen zakonom. br. 04/L-111, izmene i dopune Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima (Službeni list Republike Kosovo br. 13/2012) dopunjen i izmenjen Zakonom br. 05/L-009), član 26 tačka 7 Statuta opštine Dečani, 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Skupština opštine Dečane, na sednici održanoj 31.10.2023 godine, prima sledeće:

ODLUKA

ZA UTVRĐIVANJE NAKNADE KOMISIJE AKCIONARA LOKALNOG JAVNOG PREDUZEĆA „HIGJIENA“ SH.A.

I.

Usvaja se Odluka o određivanju naknade Komitetu akcionara NPL „Higijena“ sh.a.

II.

Svaki član Odbora akcionara biće naplaćen za svaki mesec u skladu sa definisanom minimalnom zaradom Lokalnog javnog preduzeća „Higijena“ sh.a. počev od dana njihovog imenovanja.

III.

Sredstva za nadoknadu akcionarske provizije uzimaće se iz budžeta Lokalnog javnog preduzeća "Higijena" sh.a.

IV.

O izvršenju ove odluke staraće se Lokalno javno preduzeće „Higijena“ doo.

V.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine i 15 dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i objavljivanja na službenom jeziku na sajtu Opštine.

01.Br.IX-6

Dečane, dt. 31.10.2023

Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38169
01 08.11.23



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008 dhe nenit 48 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.nr.IX-5, dt.31.10.2019, në harmoni me nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.10.2023, miraton këtë :

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

I.

Me këtë Vendim Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I. e Vendimit të Kuvendit të dt. 30.12.2021, për Themelimin e Komitetit të Komuniteteve, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e kuvendit të dt.31.01.2022, 01.Nr.I-6, Vendim i Kuvendit të Komunës së Deçanit.

- APROVOHET dorëheqja e parevokueshme e anëtarit të Komitetit të Komuniteteve, z.Sokol Rrukaj- përfaqësues i komunitetit Ashkali, dorëzuar me shkrim, shkresa me nr.01-32430, dt.20.09.2023.
- Anëtar i Komitetit të Komuniteteve nga komuniteti Ashkali, me propozimin e Zyrës Lokale për Komunitete dhe Kthim, emërohet z.Bashkim Rrukaj nga fshati Shaptej, nga i njëjti komunitet - përfaqësues i komunitetit Ashkali,

II.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- Anëtari i dorëhequr dhe anëtari i emëruar në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-7

Deçan,dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38166
01 08.11.23



Na osnovu člana 53. Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 "Službeni list Republike Kosovo" br. 28 od 04.06.2008. godine i člana 48. i člana 52. Statuta opštine Dečane 01.nr.IX-5, dt.31.10.2019, U skladu sa članom 7, 8 i 9 Administrativnog uputstva (ZPU) br.05/2020 o proceduri osnivanja, sastavu i ovlašćenjima stalnih komisija i drugih komisija u opštini, Skupština opštine Dečane na sednici održanoj dana dt. 31.10.2023, odobrava ovo:

ODLUKA

DA PROMENI I ZAMENI KOMITET ZA ZAJEDNICE

I.

Ovom Odlukom mijenja se i dopunjava tačka I. Odluke Skupštine dt. 30.12.2021, za osnivanje Odbora zajednica, izmenjen i dopunjen Odlukom Skupštine od 31.01.2022, 01. br. I-6, Odlukom Skupštine opštine Dečani.

- ODOBRAVA neopozivu ostavku člana Komiteta zajednica, g-dina Sokola Rrukaja – predstavnika zajednice Aškalija, podnetu u pisanoj formi, dopisom br.01-32430, od 20.09.2023.

- Član Komiteta zajednica iz zajednice Aškalija, na predlog Lokalne kancelarije za zajednice i povrata, imenuje se g-din Baškim Rrukaj iz sela Šaptej, iz iste zajednice – predstavnik zajednice Aškalija.

II.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine i 15 dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i objavljivanja na službenom jeziku na sajtu Opštine.

Odlukom se proglašavaju:

- član u ostavci i član imenovan u tački I. Odluke,
- MAPL i
- Arhiva opštine Dečane.

01.Br.IX-7

Dečane, dt. 31.10.2023

Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38166
01 08.11.23



Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008) dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, bazuar në nenin 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, neni 6 pika 3.1 Dy anëtarë të komisionit të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi i komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.10.2023, miraton këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORIT/ZËVENDËSDREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024

I.

Me këtë vendim bëhet emërimi i anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit / Zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave në Komunën e Deçanit, për vitin shkollor 2023/2024, në këtë përbërje:

1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit,
2. Bashkim Berisha- Drejtor i Institucionit arsimor,
3. Një anëtar nga MASHTI, i cili përcaktohet nga MASHTI, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA.

II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave në Komunën e Deçanit konform procedurave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr.151/2020.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.IX-8

Deçan.dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan 38159
01 08.11.23



Na osnovu člana 40 stav 40.2 tačka e) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 ("Službeni list Republike Kosovo", br. 28/2008) i člana 26 tačka 9 Statuta Opština Dečani 01.Nr.IX-5 od datuma 31.10.2019, na osnovu člana 6. stav 3. stav 3.1 Administrativnog uputstva (MONT) br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne ustanove za obrazovanje i preduniverzitetsku obuku u Republici Kosovo, izbor i Procedure imenovanja, Završetak ugovora i Privremeno imenovanje, član 6 tačka 3.1 Dva člana komisije koja su predložena od strane DKA i odobrena od strane Skupštine opštine, Skupština opštine Dečani na svom sastanku održanom 31.10.2023, usvaja ovo:

ODLUKA ZA IMENOVANJE ČLANOVA KOMISIJE ZA IZBOR DIREKTORA/PROREKTORA/ŠKOLA U OPŠTINI DEČAN ZA ŠKOLSKU 2023-2024.

I.

Ovom odlukom imenuju se članovi Komisije za izbor direktora/zamenika direktora škola u opštini Dečani za školsku 2023/2024. godinu, i to:

1. Dževat Boždaraj-DKA-šef sektora za obrazovanje,
2. Baškim Beriša - direktor obrazovne ustanove,
3. Član iz MESTI, koga odredi MESTI, nakon prijema zvaničnog obaveštenja, službenog mejla od DKA.

II.

Komisija je odgovorna za razvoj procedure zapošljavanja direktora/zamenika direktora/direktora škola u opštini Dečani u skladu sa procedurama definisanim Administrativnim uputstvom (MONT) br. 151/2020.

III.

O sprovođenju ove Odluke stara se Uprava za obrazovanje opštine Dečani.

IV.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine i 15 dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i objavljivanja na službenom jeziku na sajtu Opštine.

V.

Odlukom se obezbeđuju oni iz tačke I. Odluke, Uprava za obrazovanje, načelnik opštine i Arhiv.

01.Br.IX-8
Dečane,dt.31.10.2023

Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ

K.K.Degan AS 38159
01 08.11.23



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 04.06.2008), nenit 3 paragrafi 1.6 dhe nenit 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 19 / 21 korrik 2022), nenit 26 pika 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR KOMUNËN E DEÇANIT 2023-2027

I.

MIRATOHET Plani i Integritetit për Komunën e Deçanit 2023-2027.

II.

Pjesë përbërëse këtij Vendimi është akti komunal me emërtimin, Plani i Integritetit për Komunën e Deçanit 2023-2027

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: MPL, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-2

Deçan,dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 38177
01 08.11.23



Na osnovu člana 12 stav 12.2 tačka d) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 (Službeni list Republike Kosovo br. 28 od 04.06.2008), člana 3 stav 1.6 i člana 25 Zakona br. 08/L-017 za Agenciju za sprečavanje korupcije (Službeni list Republike Kosovo / br. 19 / 21. jul 2022), član 26 tačka 3 Statuta opštine Dečane, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Skupština opštine Dečane, na sednici održanoj 31.10.2023 godine, prima sledeće:

ODLUKA ZA ODOBRENJE PLANA INTEGRITETA OPŠTINE DEČAN 2023-2027

I.

USVAJA SE Plan integriteta za Opštinu Dečane 2023-2027.

II.

Sastavni deo ove Odluke je opštinski akt sa nazivom Plan integriteta za Opštinu Dečani 2023-2027.

III.

Za sprovođenje ove Odluke stara se Kabinet Predsednika opštine i opštinske direkcije.

IV.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine i 15 dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i objavljivanja na službenom jeziku na sajtu Opštine.

V.

Odlukom se obaveštavaju: MPL, Kancelarija predsednika opštine, opštinske direkcije i arhiva opštine Dečani.

01. br. IX-2

Dečan, 31.10.2023


Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38177
01 08.11.23



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET

2023 - 2026



Përmbajtje

Deklarata e Integritetit.....	3
Hyrja	4
PLANI PËR INTEGRITET	5
Parimet e menaxhimit të Integritetit	6
Objektivat e Planit të Integritetit.....	7
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	7
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	8
Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	8
Matrica e vlerësimit të rrezikut.....	9
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut	10
Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi	10
Fushat e rrezikut	12
Fushat e përgjithshme të Rrezikut	13
Fushat specifike të rrezikut	18

DEKLARATA PER INTEGRITET

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklarate gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që komuna të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.

Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Me gjithë përkushtimin tonë duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i rrezikut të integritetit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojme sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Deçanit dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

BASHKIM RAMOSAJ
KRYETAR I KOMUNES SË DEÇANIT



Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Deçanit ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2026.

Plani i integritetit është një dokument brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohen çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Institucion dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucion.

Plani rritet përkushtimin e Komunes së Deçanit për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Përmes Planit të Integritetit synohet të arrihet:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuar;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Institucioni.

Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdolloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një Komunë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo - profesionale.

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saj organizative, duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëloj mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë Komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponoheshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të punonjësve komunalë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij plani, Komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, Komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Deçanit e ka bërë në periudhën 2023 - 2026. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo - materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin prapë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

Parimet e menaxhimit të Integritetit

Lidershipi

Menaxhmentit i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjithë stafi dhe palët interesit.

Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes, duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komunitat që t'iu kushtojnë vëmendje të gjitha njësive dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvlerësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brendapërbrenda grupit punues në Komunë.

Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.
- Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës. I gjithë stafi komunal ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza përgatitore** – Kryetari i Komunës themelon grupin e punues; përcakton strukturën e grupit punues dhe kryesuesin e tij, mund të delegojë një zyrtar për ta udhëhequr grupin; Kryetari emëron koordinatorin për zhvillimin e planit të integritetit; Grupi punues bënë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimi i të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Komunës; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bënë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve.
- **Faza e përcaktimit të prioritetëve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – kjo fazë përfshin përcaktimin e prioritetëve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësitë për zbatim.
- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirëson zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të Komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e Komunës në rrugë të mbarë. Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja/Ndikimi	Madhor	10																		
		9																		
		8																		
	Mesatar	7																		
		6																		
		5																		
		4																		
	Vogël	3																		
		2																		
		1																		
Intensiteti i rrezikut (Gjasat – ndikimi)		Ulet			Mesatar							Lartë								
		Probabiliteti-Gjasat																		

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x gjasat (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1-15 pikë	16-48	49-100

 **Rreziku me intensitet të ulët** – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 **Rreziku me intensitet të mesëm** – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 **Rreziku me intensitet të lartë** – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm.

Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të integritetit kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, raporti duhet të dërgohet për diskutim në Kuvendin Komunal.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Grupi punues** - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- ❖ promovimin e integritetit në Komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;
- ❖ hartimin e draftit të Planit Komunal të Integritetit;

- ❖ përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;
- ❖ siguron që Planit të Integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
- ❖ zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
- ❖ propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit komunal për integritet. Kryetari i Komunës themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. Koordinatori për integritet - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- ❖ Përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;
- ❖ Raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- ❖ Të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- ❖ Sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit;
- ❖ Harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.
- ❖ Pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- ❖ Përgatitë dhe shpërndan pyetësozin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- ❖ Në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;

Koordinatori, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatorin i rekomandon Kryetari për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

1. Udhëheqja dhe menaxhimi;
2. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
3. Planifikimi dhe Menaxhimi i Buxhetit dhe Financave;
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve;
5. Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare

Fushat specifike të rrezikut ¹

1. Auditimi i Brendshëm;
2. Prokurimi publik;
3. Menaxhimi i kontratave publike;
4. Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
5. Planifikimi urban dhe rural;
6. Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
7. Inspektimet;
8. Arsimi Publik;
9. Shëndeti publik;
10. Menaxhimi i pronës së paluajtshme komunale;
11. Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët komunal;
12. Sektori i turizmit

¹Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Komunave.

FUSHATEPËRGJITHSHMETËRREZIKUT										
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / Eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
1.	Udhëheqja dhe menaxhimet	Objektivat dhe prioritetet zhvillimit të komunës të jenë transparente	Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brendshme të komunës, Plani integritetit	6	8	24	Hartimi i Planit Zhvillimor dhe hartave zonale	Kuvendi dhe kryetari i komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjës	Qershor – shtator 2024	
		Mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse në Planin Zhvillimor.					Përfshirja e të gjithë aktereve (komuniteti i biznesit, fokus grupeve, shoqëria civile dhe qytetarët) në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës			
		Opinion publik me opinion negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës të pamjaftueshme					Plani i konsultimeve publike në hartimin e Planit Zhvillimor	Kuvendi dhe kryetari i komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjës	Korrik – shator 2024	
				1	8	32	Informimi dhe komunikimi me qytetarët përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit (Ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, takimet e drejtpërdrejta me qytetarët)	Kryetari i Komunës, Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtorët e drejtorive	Korrik –shator 2024	

							Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin dhe konsultimin e politikave publike në procesin e vendimmarrjes	Kryetari i komunës, Drejtorët e drejtorive	Korrik –shator 2024
		Mospërputhja dhe paqartësia në administratën komunale		5	8	40	Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës	Kryetari i komunës, Njësia e burimeve njerëzore, drejtorët e drejtorive, udhëheqësit e sektorëve	Dhjetor 2024
		Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit		3	8	27	Hartimi i planit të monitorimit dhe zbatimit të planit të integritetit	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Agjencia kundër korrupsion	Dhjetor 2024
							Te rishikohet niveli i zbatimit dhe përditësohen masat për përmirësime.	Menaxheri i Integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i Integritetit	Çdo gjashtë muaj
2.	Politika e burimeve, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	5	8	40	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Dhjetor
				5	8	40	Hartimi i planit të vlerësimit vjetor të zyrtareve komunal.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Çdo fillim vit
							Analizimi i nevojave për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Çdo muaj sipas nevojës
							Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve në të gjitha drejtoritë/njësitë		
							Hartimi i një analize për ndikimin e trajnimeve		

		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate.		4	7	28	Të bëhet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	Sipas nevojës çdo tre muaj
							Harmonizimi i përshkrimit të vendeve të punës.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Gjatë gjithë vitit
		Mungesa e kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit.		7	10	70	Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit	Kryetari i komunës dhe Kuvendi, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Qershor-dhjetor
		Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës		4	7	28	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbytjen e Kodit.	Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Gjatë gjithë vitit
3	Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave	Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.		5	8	40	Mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.	Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, koordinatori i planit sipas nevojës të integritetit dhe sinjalizuesi	Çdo muaj sipas nevojës
		Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.	Ligjet, aktet nënligjore; KAB, dhe aktet e brendshme të	6	7	42	Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	TM2 – TM3 i vitit fiskal

		komunës				Përfshirja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;	Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës; zyrtari kryesor financiar	TM2 – TM3 i vitit fiskal
		Mosmiratimi me kohë i buxhetit	5	10	30	Planifikimi dhe aprovimi i buxhetit sipas KAB-it dhe Qarkoreve buxhetore	Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive	30 shtator i çdo viti
		Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent	7	8	24	Planifikimi i saktë i shpenzimeve	Njësitë buxhetore	Pas aprovimit të buxhetit vjetor
						Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF	Çdo tremujor
						Publikimi i shpenzimeve në ueb faqen e komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF Zyra për Komunikim me Publikun	
						Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF	Çdo here sipas nevojës
		Mos regjistrimi në E-pasuri	5	10	30	Funksionalizimi i depos /depoist	Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Çdo gjashtë muaj
		Inventarizimi dhe regjistrimi i efikasitetit të pasurisë jo financiare	6	8	14	Përditësimi i regjistrimit të brendshëm të aseteve të komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi

	Ruajta dhe siguria e te dhënave dhe dokumenteve	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës.	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative	Kryetari i komunës, Drejtorja e Administratës dhe sektori i TIK-ut	TM1 2024
							Informimi i të gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara	Drejtorja e Administratës dhe sektori i TIK-ut	Në vazhdimësi
		Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit		3	8	24	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar	Kryetari i komunës, Drejtorja e Administratës	Tremujori i katërt 2025 2026
5.	Plani komunal për pjesëmarrjen e qytetareve	Moszbatimi i planit komunal	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet tjera, duke përfshirë Planin komunal për pjesëmarrje qytetare	5	8	40	Transparenca e punës së kuvendit komunal	Kryesuesi/s ja e kuvendit, sekretaria e kuvendit, Zyra për Komunikim me Publikun	Në vazhdimësi
		Mos mbajtja e konsultimeve publike					Plani vjetor i konsultimeve publike	Kryetari i komunës, Drejtoritë, Zyra për Komunikim me Publikun	TM1 i çdo viti
		Moszgjidhja dhe mosfeksionimi i këshillave lokale					Zgjedhja e këshillave lokale, funksionimi i tyre dhe plani vjetor i bashkëpunimit me komunën	Kuvendi, i komunës, Kryetari i komunës, Drejtorja e Administratës	Në vazhdimësi
		Mos themelimi i komiteve konsultative					Themelimi i komiteve konsultative në harmoni me nevojat e komunës	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës	Për çdo mandat dhe sipas nevojave

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT										
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / Eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
1.	AUDITIMI I BRENDSHËM	Mungesa e planifikimit vjetor të auditimit.	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	4	8	32	Para se të hartohet Planit Vjetor të bëhet rivlerësim i rrezikut.	Njësia e auditimit, Komiteti i auditimit.	Në fillim të çdo viti	
		Mungesa e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit					Të bëhet auditimit sipas Planit Vjetor			
		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësive të Auditimit, Komitetit dhe Kryetarit		3	8	36	Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit	ZKF dhe drejtoritë e përfshira në raportin e auditimit		Gjatë vitit në përcjellje dhe raportin
							Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	ZKF		TM i vitit fiskal
				5	8	40	Të rritet koordinimi dhe komunikimi në mes të njësive të auditimit dhe njësive sektoriale	Kryetari i komunës, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe nj	Në vazhdimësi	
2	PROKURIMI	Mungesa e planifikimit vjetor të prokurimit publik	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	5	10	50	Ngritja e kapaciteteve për hartimin e planit vjetor të prokurimit publik dhe zbatimin e tij.	Njësia e prokurimit, Drejtoritë dhe njësitë sektoriale	Gjatë gjithë vitit sipas nevojës Të stafit	

						Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për zyrtarët që ndërlidhen me prokurimin publik	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	
		Mungesa e transparencës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik		55	2	40	Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës	Njësia e prokurimit	Pas miratimit të planit të prokurimit
3	MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE	Mungesa e dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik lokal		4	4	36	Hartimi, miratimi dhe rishikimi i dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik të komunës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Në vazhdimësi
							Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave		Në vazhdimësi
4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA	Mungesa e dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik lokal		4	4	36	Hartimi, miratimi dhe rishikimi i dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik të komunës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Gjate gjithë vitit
		Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo transparente.		5	7	35	Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës	Kryetari i komunës, Drejtoritë	M2/TM3
							Të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë aktoreve relevant gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal.		
		Kritere jo të qarta dhe transparencë të pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve për zhvillim e bujqësisë dhe sektorëve tjerë					Ndarja e subvencioneve të bëhet sipas Rregullores komunale	Kryetari i komunës (komisionet), Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Gjatë vitit
							Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Gjate gjithë vitit

5	PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL	Mos hartimi i dokumenteve të planifikimit që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës.	8	7	72	Të fillohet me hartimin e dokumenteve të planifikimit në mënyrë që të kemi të përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kuvendi Komunal Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Tremujori i parë 2026
		Mos hartimi i raportit monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal nga të gjitha Drejtorit sektoriale të Komunës.		5	6	45	Raportimi i rregullt në baza vjetore për zbatimin e të gjitha objektivave të deklaruara në PZHK.	Drejtoria për Urbanizëm dhe të gjitha drejtorit tjera sektoriale të Komunës	Në baza vjetore
		Numri i vogël i stafit profesional për mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural		6	8	48	Të shtohet numri i stafit profesional për planifikim urban dhe rural		
							Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit		
		Mos zbatimi i afateve ligjore bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor për hartimin e dokumenteve të planifikimit.		8	7	72	Zbatimin e afatit ligjor bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174	Kryetari i komunës, Drejtoria për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	
6	STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI	Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet (vend punishtet)		7	8	62	Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje	Kryetari i komunës, Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Në vazhdimësi

		Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës dhe planet rregullative urbane	5	10	30	Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Tremujori i dytë 2026
							Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural		
7	Inspektimet	Mungesa e Planit vjetor të inspektimeve	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës	3	5	5	Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtoria e inspektimeve	Në vazhdimësi
		Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve		5	8	40	Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët	Drejtoria e inspektimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve		5	8	40	Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja	Kryetari i komunës, Drejtoria e inspektimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Gjate gjithë vitit
8	Arsimi publik	Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës	5	8	40	Të sigurohet planifikim të shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes/zvogëlimit të numrit të nxënësve.	Kryetari i komunës dhe Drejtoria e arsimit	TM2/TM3
		Inspektimet e pamjaftueshme të procesit mësimor		5	10	50	Të hartohet, zbatohet dhe mbikëqyret plani i inspektimeve	Kryetari i komunës dhe Drejtoria e arsimit	Në vazhdimësi
9	Shëndeti publik	Mangësi në rregullat e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës si dhe	5	7	15	Të rishikohet rregullative e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit. Të shtohet kontrolli i	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për shëndetësi	Gjate gjithë vitit

		shëndetësore dhe zbatimi jo i plotë i saj	planet dhe strategjitë në shëndetësi				zbatimit të rregullativës.		
		Funksionimi jo efikas i Sistemit të informacionit shëndetësor				24	Funksionalizimi i Sistemit të informacionit Shëndetësor / Përmirësimi i shërbimeve ndaj pacientëve	Drejtoria për shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore	Gjate gjithë vitit
							Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike	Drejtoria për administratë dhe njësia e TIK-ut	
							Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër	Mbikëqyrësi i shërbimeve publike	Në vazhdimësi
							Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbim të përvojave, punëtorive	Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	
		Mangësi në rregullativen e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve		4		36	Të zhvillohet rregullative e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve	

		Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për licencimin e shërbimeve		3	0	27	Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve	Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	
		Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve		5	0	45	Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij		
10	MENAXHIMI I PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE	Mungesa e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	5	10	30	Miratimi dhe publikimi i listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Çdo muaj dhjetor
		Mos mbikëqyrja e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale					Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe raportimin pronave të paluajtshme komunale të dhënies në shfrytëzim	Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Dy here ne vit

11	PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR ZYRTARËT KOMUNAL	Vendimmarrje të rastet e konfliktit të interesit	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	2	4	12	Deklarimi dhe shmangia nga vendimmarrja në rastet e konfliktit të interesit	Zyrtarët komunalë	Gjate gjithë viti
		Mos deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë komunal					Deklarimi i pasurisë sipas afateve ligjore	Njësia e Burimeve Njerëzore	Gjate gjithë vitit
12	Sektori i turizmit	Mungesa e Planit për zhvillimin e turizmit	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	2	4	11	Hartimi i planit për zhvillimin turizmit lokal	Drejtoria për zhvillimin ekonomik	Qershor 2026



Në bazë të nenit 5 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16 e datës 26 qershor 2015), nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 04.06.2008), nenit 26 pika 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR BARAZI GJINORE PËR KOMUNËN E DEÇANIT 2023-2027

I.

MIRATOHET Plani për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2023-2027.

II.

Pjesë përbërëse këtij Vendimi është akti komunal me emërtimin, Plani për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2023-2027

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës – Zyra për Barazi Gjinore.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: MPL, Kryetari i Komunës – Zyra për Barazi Gjinore dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-3

Deçan, dt.31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38174
01 08.11.23



Na osnovu člana 5 stav 1.2 Zakona br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova (Službeni list Republike Kosovo br. 16 od 26. juna 2015. godine), člana 12 stav 12.2 tačka d) Zakona o lokalnoj samoupravi -Vlada br. 03/L-040 (Službeni list Republike Kosovo br. 28 od 04.06.2008), član 26 tačka 3 Statuta opštine Dečane, 01.Nr.IX-5 tš dt.31.10.2019, Skupština opštine Dečane, na sednici održanoj 31.10.2023 godine, prima sledeće

ODLUKA

ZA ODOBRENJE PLANA RAVNOPRAVNOSTI RODOVA ZA OPŠTINU DEČAN 2023-2027

I.

USVAJA SE Plan za rodnu ravnopravnost za Opštinu Dečani 2023-2027.

II.

Sastavni deo ove odluke je opštinski akt pod nazivom Plan za rodnu ravnopravnost za opštinu Dečani 2023-2027.

III.

O sprovođenju ove Odluke stara se načelnik opštine – Kancelarija za ravnopravnost polova.

IV.

Odluka stupa na snagu nakon potpisivanja od strane predsednice Skupštine i 15 dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i objavljivanja na službenom jeziku na sajtu Opštine.

V.

Odlukom se obaveštavaju: MPL, predsednik opštine – Kancelarija za rodnu ravnopravnost i arhiva opštine Dečani.

01.Br.IX-3

Dečane, dt.31.10.2023


Predsednik Skupštine
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 38174
01 08.11.23



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



OBJEKT

PLANI KOMUNAL PËR BARAZI GJINDORE 2023-2027



PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Komunës.....	3
Vendimi.....	4
Indeksi i shkurtesave.....	5
Indeksi i tabelave.....	6
1. Hyrja	7
1.1 Baza ligjore për barazi gjinore.....	8
1.2 Qëllimi dhe objektivat e planit komunal për barazi gjinore 2023-2027.....	9
1.3 Metodologjia.....	12
2. Analiza e përgjithshme gjinore në komunën e Deçanit.....	13
3. Plan komunal i veprimit për barazi gjinore, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027.....	18
4. Plan i monitorimit të zbatimit të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027.....	27
5. Plan i monitorimit dhe vlerësimit	29



nga afër me përpikëri këtë plan.

Kam nderin dhe kënaqësinë t'ju njoh me Planin Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, i cili është dokumenti i rëndësishëm së veçantë për qytetarët e Deçanit dhe Institucionin Komunal, njëkohësisht, për faktin që ky plan është hartuar për katër vite dhe përcakton se; barazia gjinore është njera ndër vlerat themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë prandaj është edhe qëllimi im, që t'i mënjanoj pengesat duke garantuar sjellje, pozitë, mundësi dhe përfitime të barabarta për të dy gjinitë në të gjitha sferat e jetës, duke detyruar institucionet ta zbatojnë

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes në fushën e barazisë gjinore në territorin e komunës. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të çdo trajtimi jo të barabartë i një individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt, në rrethana të njëjta, apo të ngjashme, ku do të konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor, andaj me këtë plan komunal i plotëson një prej kërkesave për hartimin e dokumentit, specifikimin e aktiviteteve për realizimin e projekteve me synim të realizimit të objektivave komunale.

Plani Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, është në përputhshmëri me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Planin Kombëtar për Veprim 2020-2023. Ky dokument do të ndihmojë po ashtu edhe në përmbushjen dhe zbatimin e politikave për barazi gjinore nacionale dhe plotësimin e kërkesave për realizimin e objektivave që dalin nga dokumentet strategjike në nivelin komunal.

Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese të barazisë gjinore, identifikuar problemet ku janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme të planit të punës për periudhën katër vjeçare në fushën e barazisë gjinore në komunën e Deçanit.

Për implementimin e këtij plani komunal do ta bëj nëpërmjet Zyrës për Barazi Gjinore me koordinimin tim, po ashtu do të bëj edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por, njëkohësisht, ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët, për implementimin e projekteve të këtij plani.

Përkushtimi im si Kryetar i Komunës, do të jetë i përqendruar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Deçanit, duke e mbështetur fuqishëm zhvillimin dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe barazisë gjinore, prioritet dhe vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë.

BASHKIM RAMOSAJ
KRYETAR I KOMUNËS SË DEÇANIT



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
DEÇAN, KOSOVO



Në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.03/L-020 për Barazi Gjinore (Gazeta Zyrtare, Nr.16, 26 qershor 2015), nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, sipas nenit 26 pikë 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.05.2022, bën këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN PLANIT PËR BARAZI GJINORE PËR KOMUNËN E DEÇANIT 2022-2026

I.

Formohet grupi punues për hartimin e Planit për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2022-2026, në këtë përbërje: Zoje Sejfiqaj, zyrtare për barazi gjinore, 2 Ajne Ibërhyraj, Inspektore e Ambientit, 3. Yllarta Thaqi, nga Asambleja (AAK), 4. Hyri Dobrunaj, nga Asambleja (LDK), 5. Teuta Nezdrupaj, nga Asambleja (LVV).

Mbledhjen e parë të Grupit punues e fiton Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Grupi e zgjedhë kryesuesin e vet.

II.

Grupi është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe ofrimin e informatare të nevojshme gjatë dhe deri në përfundimin e procesit të finalizimit të hartimit të Planit për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2022-2026

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.


IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.

01.Nr.VIII-6
Deçan, dt. 30.05.2022



Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ

Indeksi i shkurtesave

ABEF - Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ABGJ - Agjencia për Barazi Gjinore
AFP - Anketa e Fuqisë Punëtore
AP- Avokati i Popullit
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPGJ - Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
CEDAW - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
IEBGJ - Instituti Evropian për Barazi Gjinore
KNKDHf - Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje
LBGJ - Ligji për Barazi Gjinore
LGBT - Lesbike, Gej, Biseksualë, Transgjitorë
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MATP - Masat Aktive të Tregut të Punës
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKBGJ - Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
PKBGJ- Plani Komunal për Barazi Gjinore
PSV - Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
QAP - Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS - Qendrat për Punë Sociale
RrGGK - Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
ShC - Shoqëria Civile
ZBGj - Zyrtari/ja për Barazi Gjinore
ZKM Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZMNv Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë e Viktimave

Indeksi i tabelave

Tabela 1 : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitin 2023-2025

Tabela 2: Shpenzimet Komunale për (Vitin 1-3) 2023-2025

Tabela 3: Numri i punëtorëve në komunën përkatëse për vitin 2023

Tabela 4: Planifikimi për vitin 2024 Niveli i pagave në Komunë

Tabela 5: Numri i përfituesve të subvencioneve, apo edhe shërbimeve të ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Tabela 6: Plani i veprimit barazisë gjinore, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027

Tabela 7: Plani i monitorimit të zbatimit të Planit Lokal për Barazi Gjinore 2023-2027

1. Hyrja

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km², e cila gjendet në pjesën Perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, me 38 vendbanime, 136 banorë për km². Plani Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, trajton barazinë ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore në komunën e Deçanit.

Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, në të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për t'i zbatuar masat legislative si dhe masat e tjera, duke përfshirë edhe miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2020-2022, prandaj Komuna e Deçanit me këtë plan komunal, ka specifikuar aktivitetet me qëllim të realizimit të objektivave për barazi gjinore.

Barazia gjinore është një e drejte themelore e përcaktuar si një parim themelor në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ku konsiderohet faktor i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale dhe stabilitet, ku ky plan komunal për barazi gjinore, për periudhën katër vjeçare 2023-2027, është përqendruar në tri shtylla kryesore:

- Shtylla e I: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale
- Shtylla e II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore
- Shtylla e III: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri

Përkushtimi për barazi gjinore thekson domosdoshmërinë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave komunale, duke respektuar kornizën ligjore dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve për të arritur qëllimin e përcaktuar për barazi gjinore.

Arritja e barazisë gjinore e paraparë edhe me Ligjin për Barazi Gjinore m. 05/L-020, i cili thekson se; barazia gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave (vajzave) dhe burrave në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi, po ashtu kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet e ndryshme si ato të arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve etj.

Me anë këtij Plani komunal, komuna e Deçanit synon të japë ndihmesën në arritjen e standardeve me të larta në trajtimin e barazisë gjinore. Ky plan komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor për barazi gjinore kombëtare si dhe akteve të tjera nënligjore dhe politikave publike për barazi gjinore.

1.1 Baza ligjore për barazi gjinore

Plani i Barazisë Gjinore në nivel qendror dhe ai lokal duhet të zbatojnë Programin e Barazisë Gjinore të aprovuar nga qeveria dhe zbatueshmëria obliguese buron nga Neni 11 i Ligjit për Barazi Gjinore dhe nga Neni 12, paragrafi 2.1 dhe 2.4, për *Zyrtaret për Barazi gjinore në ministri dhe komuna*, ku shprehimisht thuhet: **Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve/ve përkatës për barazi gjinore përfshijnë koordinimin e zbatimit të këtij ligji, si dhe të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe bashkëpunimin me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe akteret tjerë përkatës në fushën e barazisë gjinore!** Programi i Kosovës për Barazi Gjinore i ka të përcaktuara specifikisht cilat janë aktivitetet që duhet të kryejnë komunat të cilat obligohen t'i kryejnë një për një sikurse janë të parapara në Program Modifikimet e mundshme ndërmerren vetëm pas konsultimeve me ABGJ-në.¹

Ligji për Barazi Gjinore 05/L-020 specifikisht, neni 5, paragrafi 1.2, i cili obligon institucionet e qendrore dhe lokale për çdo politike që ndërmerri (ligj, rregullore, urdhërese, apo plan veprimi, strategji, projekt apo program) duhet të përfshijnë barazinë gjinore, në përputhje dhe bazuar në analize gjinore të politikës që propozohet. Pra nëse një komunë do të hartojë p.sh. programin e granteve për bujqësinë duhet të përfshijë perspektivën gjinore, nëse do të ndërtojë/përmirësojë infrastrukturën dhe transportin duhet të përfshijë perspektivën gjinore, etj.²

Ky plan ka për qëllim sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave, ligjet më kryesore janë si në vijim.

Korniza ligjore dhe politikat vendore për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për barazi Gjinore Nr. 05/L-020;
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje Nr. 03/L-182;
- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26;
- Ligji i Familjes Nr.2004/32;
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.05/L-021;
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154;
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212.³

Korniza zhvillimore vendore dhe veprimet për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave:

- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim
- Programi i Reformave Ekonomike
- Strategjia për Rregullim më të Mirë
- Strategjia Nacionale dhe Plani i veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
- Qarkorja Vjetore Buxhetore dhe strategjitë e tjera.

¹ Edi Gusia. Zv. Drejtoreshë Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore

² Edi Gusia. Zv. Drejtoreshë Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore

³ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

Parimet kryesore të cilat janë marrë parasysh për hartimin e këtij plani janë:

- Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut
- Barazia gjinore është kontribuues për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë
- Komuna duhet të zotërojë kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e planit komunal për Barazi Gjinore 2023-2027

Qëllimi i Planit Komunal për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të të gjitha proceseve e aktiviteteve politike, projekteve dhe programeve të qeverisë në komunën e Deçanit.

Shtylla I: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale

Objektivi strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për dy gjinitë për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.

Ky objektivi ka për qëllim të sigurojë avancimin dhe fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, duke përmirësuar shpërndarjen, promovimin e drejtave me anë të punësorëve dhe trajnimeve, mbështetjen dhe pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e burimeve. Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e dy objektivave specifikë të mëposhtëm:

Rritja e punësimit të grave dhe vajzave

Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohen mundësi për rritjen e aktivizimit të grave në tregun e punës dhe rritjen e shkallës së punësimit të tyre. Për të arritur këtë objektivi, aktivitetet do të kryhen në drejtimet në vijim:

- Ngritja e shkathtësive të grave, me anë të punësorëve, kurseve, trajnimeve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Promovimi i drejtave me anë të organizmit të punësorëve me qëllim të njohjes drejtën kundër diskriminimit në punësim, pushimin e lehonisë dhe pushimin atësor, në pajtim me direktivën e BE-së për balancë të jetës dhe punës;
- Promovimi, fushata sensibilizuese, duke ofruar njohuri me anë të punësorëve, ofrimi i qasjes në shërbime sociale dhe familjare cilësore, dhe persona me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar kështu mundësitë e grave për tu aktivizuar në tregun e punës; dhe
- Fushata njoftuese për mbështetjen financiare, për të rritur angazhimin e grave në ndërmarrësi dhe rritjen e bizneseve në pronësi të grave.

Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime.

Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohet që gratë kanë qasje të barabartë në të drejta, burime dhe shërbime. Më specifikisht ky objektivi synon të sigurojë shpërndarjen e barabartë në mbështetjen financiare, financa dhe shërbime.

Aktivitetet do të kryhen në këto drejtime:

- Fushata, punëtori rreth zhvillimit të udhëzuesve, dhe ngritjes së kapaciteteve për të mundësuar zbatimin e plotë dhe të saktë të Ligjit për Barazi Gjinore dhe konventave dhe standardeve ndërkombëtare për barazi gjinore.

Duke përfshirë edhe analizën buxhetore për barazi gjinore, duke përfshirë trajnime punëtori për ngritjen e kapaciteteve për mënyrën e zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;

Integritet të perspektivës gjinore në politikat publike, shpërndarjes së informatave dhe mbështetjes në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të dy gjinive. Realizimi i të drejtës në pronë dhe trashëgimi

Shtylla e II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore. Synohet të arrihet përmes këtyre veprimeve:

- Organizimin e aktiviteteve vetëdijësuese, punëtori dhe trajnime me dy gjinitë dhe grupmosha të ndryshme për t'i kontribuar parandalimit të braktisjes së shkollimit;
- Krijimin e mundësive dhe i qasjes në shërbime për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve;
- Krijimin e skemave mbështetëse për vajzat dhe gratë për t'u angazhuar dhe avancuar në punë;
- Trajnime dhe punëtori rreth pasojave që mund të sjellë përdorimi i gjuhës së stereotipeve, gjuhës dhe praktikës pedagogjike diskriminuese nga plan programet dhe tekstet mësimore;
- Ngritjen e kapaciteteve të sistemit arsimor, për t'i zbatuar mekanizmat ekzistues për arritjen e barazisë gjinore;
- Përkrahje financiare për avancim profesional (studentet, bizneset fillestare) etj.
- infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave, grave në sport;
- Trajnime dhe punëtori rreth pasojave që mund të sjellë në shoqëri, si dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm;

- Monitorimi dhe vlerësimi në të tri fushat, duke përfshirë: Integrimin e të dhënave personale në SISH për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës (duke përfshirë edhe dhunën ndaj grave në të gjitha format);
- Trajnime dhe punëtori mbi praktikën e planifikimit familjar;
- Trajnime dhe punëtori rreth programeve edukative dhe vetëdijësuese, me fokus të veçantë shëndetin riprodhues;
- Trajnime dhe punëtori rreth për trajtim dhe monitorim për përmirësimi i qasjes në shërbime në vendet rurale; ngritja e kapaciteteve profesionale (për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojat specifike shëndetësore të grave dhe burrave;
- Trajnime dhe punëtori rreth organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për shëndetin mendor (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, seksualitetin, etj.);
- Trajnime dhe punëtori rreth trajnimit të mësimdhënësve në shkollat komunikim për shëndetin riprodhues dhe seksual;
- Zgjerimi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, si dhe përfshirja e shtuar në këto vizita të nënave dhe fëmijëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane; dhe

Shtylla e III: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve kryesore:

- Trajnime dhe punëtori rreth përfshirjes së normave jo diskriminuese, në përputhje dhe me kërkesat e Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) të Kombeve të Bashkuara 2030; Infrastrukturës ligjore Kombëtare, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Planit Kombëtar për Barazi Gjinore 2020-2022
